



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", ish - hotel "Drini", Tiranë

Tel:04 2268141; Fax: 2268142

Nr. 1356/12 aktit

Tiranë 27.08.2017

V E N D I M

Nr. 185, datë 27.07.2017

***“Mbi përfundimin e procedimit administrativ,
filluar me urdhrin e verifikimit nr. 1356/1 prot., datë 11.07.2017”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të lëvizjes paralele, sipas shpalljes nr. 1545, të DAP, në kategorinë ekzekutive, për pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Arkiv-Protokollit”, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar,

VËREJ SE

Me Urdhrin nr. 1356/1 prot., datë 11.07.2017, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u verifikua informacioni i përcjellë nëpërmjet kërkesës nr. 1356 prot., datë 03.07.2017, që lidhet me ligjshmërinë e procedurës së lëvizjes paralele, sipas shpalljes nr. 1545, të DAP, në kategorinë ekzekutive, për pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Arkiv-Protokollit”, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, ku fituese është shpallur kandidatja *****.

Në zbatim të urdhrin të mësipërm, nëpërmjet shkresës nr. 1356/2, datë 11.07.2017, shkresës nr. 1356/3, datë 11.07.2017, shkresës nr. 1356/3, datë 11.07.2017 dhe shkresës nr. 1356/4, datë 11.07.2017, u vunë në dijeni Autoriteti Rrugor Shqiptar, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave si dhe Departamenti i Administratës Publike, për fillimin e këtij verifikimi, si dhe u kërkua nga institucionet, dokumentacioni i nevojshëm për realizimin e tij.

Nga aktet e administruara rezulton se, punonjësja ***** , ka filluar marrëdhënien e punës (në periudhë prove), bazuar në aktin e emërimit nr. 5629, datë 16.11.2015, të DAP, në pozicionin

e punës “*Specialist Arkiv/Protokoll*”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, IT dhe Redaktimit, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, në Drejtorinë e Përgjishme të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

Në vijim, konstatoj se në përfundim të periudhës së provës, me shkresën nr. 371/1 prot., datë 03.02.2017, të Departamentit të Administratës Publike, kjo punonjëse është konfirmuar nëpunëse civile, në pozicionin “*Specialist Arkiv/Protokoll*”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, IT dhe Redaktimit, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, në Drejtorinë e Përgjishme të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

Më tej, rezulton se bazuar në njoftimin e DAP, në lidhje me procedurën e lëvizjes paralele, nr.1545, për pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Arkiv-Protokollit, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar*”, kjo nëpunëse ka aplikuar sipas kushteve dhe kriterëve të kërkuara në këtë njoftim.

Në procedurën e lëvizjes paralele, ndër të tjera, është kërkuar që kandidatët duhet të plotësonin kushtet dhe kriteret e veçanta si vijon : të jenë nëpunës civilë të konfirmuar në kategorinë III-b, IV-a, IV-b, IV-c; të mos kenë masë disiplinore në fuqi; të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”, si dhe të plotësojnë kërkesat e veçanta si vijon: të zotërojnë një diplomë të nivelit “*Master Shkencor*” në një nga fushat e arsimit të lartë, në të cilën edhe diploma e nivelit “*Bachelor*” duhet të jetë në të njëjtën fushë; të kenë të paktën një vit përvojë pune në arkiv-protokoll.

Konstatohet se, me urdhrin nr. 5256 prot., datë 22.06.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH-së, është ngritur “*Komisioni i Brendshëm për lëvizjen Paralele në Kategorinë Ekzekutive për pozicionin e punës Përgjegjës i Sektorit të Arkiv-Protokollit, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar*”, sipas shpalljes nr.1545.

Ky komision, pasi ka kryer hapat proceduralë të njoftimeve dhe shqyrtimit të kandidaturave, bazuar në pikat 19 dhe 20, të Kreut VII të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhës së provës dhe emërimit në kategorinë ekzekutive*”, në përfundim të fazës së vlerësimit, ka renditur kandidatët si më poshtë : *****, me shumën totale të pikëve 87.3, *****, me shumën totale të pikëve 81.3, ndërsa kandidatja ***** nuk u paraqit.

Në këto kushte rezulton se, bazuar në rezultatet e mësipërme, DAP me njoftimin nr. 1545, për pozicionin e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Arkiv-Protokollit, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar*”, ka shpallur kandidat fitues, *****.

Me anë të kërkesës nr. 1356 prot., datë 03.07.2017, drejtuar Komisionerit, pjesmarrësi në konkurrim, Egest Çano, ka parashtruar se përzgjedhja e kandidates fituese ***** , është bërë në mënyrë subjektive, në kundërshtim me parashikimet e njoftimit, në tejkallim të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, akteve nënligjore, si dhe praktikave të aplikuara në rastet e rekrutimit të stafit në kushtet e lëvizjes paralele, etj.

Në lidhje me këtë pretendim, konstatoj se në shpalljen e DAP nr.1545, për lëvizjen paralele, në kategorinë ekzekutive, për pozicionin e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Arkiv-Protokollit*”, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, është përcaktuar lloji i

procedurës dhe kategoria për të cilën është publikuar shpallja, në rastin konkret “*Lëvizje paralele dhe pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive*”, si dhe janë parashikuar kushtet e përgjithshme dhe kërkesat specifike, ashtu si janë specifikuar më sipër.

Sipas ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, plotësimi i vendeve të lira në kategorinë ekzekutive bëhet, fillimisht nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe në këtë procedurë mund të aplikojnë nëpunës civilë të së njëjtës kategori në të njëjtin institucion apo në një institucion tjetër të shërbimit civil. Sipas nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, pozicionet në shërbimin civil klasifikohen sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit, si edhe janë përcaktuar se cilat janë kategoritë e nëpunësve civilë si më poshtë :

- *Kategoria e nivelit të lartë drejtues;*
- *Kategoria e nivelit të mesëm drejtues;*
- *Kategoria e nivelit të ulët drejtues;*
- *Kategoria ekzekutive.*

Nga sa më sipër, në çdo procedurë konkurrimi, të nocionit “*kategori e nëpunësve civilë*”, do të kuptohen kategoritë e përcaktuara në nenin 19, të ligjit të mësipërm, dhe jo kategoritë e pagave.

Më tej rezulton se, në zbatim të kompetencës ligjore, që është përcaktuar në pikën 9/a, të dispozitës në fjalë, Këshilli i Ministrave, me Vendimin nr.187, datë 08.03.2017, “*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit*”, ka miratuar klasat e zbatueshme për secilën nga kategoritë.

Nga përmbajtja e këtij akti nënligjor, rezulton se në kategorinë ekzekutive, ku përfshihen pozicionet e punës “*specialist*”, në rastin e disa institucioneve të varësisë, në kuptim të ligjit për nëpunësin civil, janë përfshirë të gjitha pozicionet e barasvlershme me kategorinë e pagës IV-a, IV-b, IV-c dhe III-b, pavarësisht emërtesës së pozicionit të punës (*përgjegjës sektori, apo drejtor drejtorie*). Në vijim të kësaj analize, duke marrë parasysh edhe procedurën dhe kriteret e publikuara nga DAP për shpalljen për plotësimin e pozicionit të punës, të cilën po shqyrtojmë, rezulton se, në disa institucione të varësisë,

- ✓ nisur nga natyra e punës, e cila është vetëm e karakterit ekzekutiv dhe nuk parashikon hartimin e politikave;
- ✓ nisur nga detyrat që realizojnë sipas përshkrimit të punës dhe kërkesat për vendin e punës, si dhe duke u bazuar në kategorinë e pagës, si element i rëndësishëm i marrëdhënies së punës, e cila është e njëjtë me atë të nivelit ekzekutiv në institucionet qendrore, (*III-b, IV-a, IV-b, IV-c*);

për arsye të administrimit të procedurave të konkurrimit, kryesisht në përcaktimin e grupeve të konkurrimit për rekrutime në nivelin ekzekutiv (*grupet e administrimit të përgjithshëm apo të administrimit të posaçëm*), si dhe të përcaktimit të kategorisë së shërbimit civil në rastet e

lëvizjes paralele, emërtesat përgjegjës sektori, apo drejtor drejtorie, me të drejtë janë cilësuar nga DAP, si pozicione të nivelit ekzekutiv.

Duke qenë e tillë konstatoj se edhe kandidati ***** ka aplikuar për praninë nga jashtë shërbimit civil, në një nivel të kategorisë ekzekutive, dhe jo si lëvizje paralele apo ngritje në detyrë, *(dy procedura që zhvillohen për nivele më të larta të nëpunësisë civile, që nuk do t'i lejonin atij pjesëmarrjen në këtë procedurë konkurrimi, pasi ai nuk është pjesë e shërbimit civil).*

Kjo për faktin se pozicionet e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, në institucionet e administratës qendrore, shpallen me procedurën e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë, e si rrjedhojë, si rregull i përgjithshëm, në këtë lloj procedure, nuk mund të aplikojnë kandidatë nga jashtë shërbimit civil, me disa përjashtime specifike që ka përcaktuar ligji, në kushtet e të cilave nuk ndodhemi në këtë rast.

Në mbështetje të argumentimit më sipër, bazuar në ligjin nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, praktikën e aplikuar nga DAP, në rastin e rekrutimit të stafit të institucionit të ARRSH-aë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, për të plotësuar një nivel ekzekutiv *(dhe konkretisht në rastin kur nëpunësja ***** është kualifikuar për të marrë pjesë në procedurën e lëvizjes paralele në pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Arkiv-Protokollit”, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, pasi i plotëson kriteret e shpalljes nr.1545 dhe në përfundim të së cilës ajo është shpallur fituese), e vlerësoj të kryer në përputhje me ligjin dhe procedurat e kërkuara në këtë rast.*

Përfundimisht, çmtoj se pretendimet e kandidatit ***** në lidhje me parregullsinë e plotësimit të pozicionit të punës në fjalë nëpërmjet lëvizjes paralele, janë të pabazuara në ligj dhe se procedura e kryer nga Departamenti i Administratës Publike, për realizimin e procedurës së lëvizjes paralele sipas shpalljes nr. 1545, të DAP, në kategorinë ekzekutive, për pozicionin e punës *“Përgjegjës i Sektorit të Arkiv-Protokollit”*, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, ku fituese ka rezultuar kandidatja ***** është realizuar në përputhje me ligjin, prandaj nuk shihet i nevojshëm investimi apo ndërhyrja, e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe në nenin 16, pika 6, dhe 34, pika 2, të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar me Urdhrin e verifikimit nr.1356/1 prot., datë 11.07.2017, *“Për verifikimin e informacionit në lidhje me procedurën e lëvizjes paralele me fituese kandidaten *****”, sipas shpalljes nr. 1545 të Departamentit të Administratës Publike.”*

2. Të njoftohen për këtë vendim, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, Departamenti i Administratës Publike, si dhe kërkuesi *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA